



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH**

Nr. 199/3 prot

Gramsh, më 03/01/2020

Vendim

Nr. 04 ,dt. 29 .01.2020

Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca civile “Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, neni 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti”, si dhe ,të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

Vendos i:

- I. Të miratohen listat në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh si më poshtë:
 1. Familja e **z.Arianit Tahir Mema** me përbërje familjare 5 vetë, nuk disponon asnjë banesë dhe ka të ardhura neto si familje 69 660 lekë në muaj. Sipas normativave të strehimit i takojnë 31.25 m², pra struktura e apartamentit 2+1, kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 5 vetë dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë **3 010 000** lekë.
 2. Familja e **znj.Irdajena Estref Llapushi** me përbërje familjare 2 vetë, grua e divorcuar dhe një fëmijë, nuk disponon asnjë banesë dhe ka të ardhura neto si familje 56 541 lekë në muaj. Sipas normativave të strehimit i takojnë 20 m², pra struktura e apartamentit 1+1, kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 2 vetë, dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë **2 580 000** lekë.
 3. Familja e **z.Emiljano Shpëtim Koçi** me përbërje familjare 2 vetë, nuk disponon asnjë banesë dhe ka të ardhura neto si familje 46 020 lekë në muaj. Sipas normativave të strehimit i takojnë 20 m², pra struktura e apartamentit të jetë garsionere, kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 2 vetë, dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë **2 150 000** lekë.

- II. Të miratohet Lidhja 3-Formati i listës emërore.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.E.Mema



Miratoi G.Lena

Dosja nr. _____

Afati _____



Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA



**LIDHJA3 – Formati i listës emërore
BASHKIA GRAMSH**

Nr. Rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbëria familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton
1	2	3	4	5	6	7	8	9	9
1	Arianit Tahir Mema	5	2+1	Nuk ka banese	Nuk ka	Nuk ka	69 660	Në shtet	3 010 000
2	Irdajena Estref Llapushi	2	1+1	Nuk ka banese	Familje njëprindërore	Grua e divorcuar	56 541	Në shtet	2 580 000
3	Emiljano Shpëtim Koçi	2	garsoniere	Nuk ka banese	Mosha e përgjithshme më pak se 60 vjet	Nuk ka	46 020	Albtelekom	2 150 000

Konc.E.Mema 

Miratoi G.Lena 

Dosja nr. _____

Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

